

Ndërmarrja Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave
N.P.L“PASTRIMI” SH.A. Hani i Elezit

PLANI I BIZNESIT 2025

Hani i Elezit, Tetor 2024

Përbajtja:

1. Përbledhje e përgjithshme.....	3
1.1 Aktivitetet primare dhe sekondare të ndërmarrjes.....	3
2. Qëllimet, Vizioni dhe Misioni.....	4
2.1 Qëllimet e kompanisë.....	4
2.2 Vizioni.....	4
2.3 Misioni.....	4
3. Swot Analiza.....	5
4. Mjetet për matjen e performancës.....	6
4.1 Indikatorët.....	6
5. Monitorimi.....	6
6. Situata aktuale në menaxhimin e mbeturinave	7
6.1 Sasia dhe përbërja e mbeturinave	7
6.2 Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe metodat e deponimit.....	7
6.3 Aspekti organizativ dhe financiar i menaxhimit të mbeturinave.....	8
7. Organizimi, shërbimet e ofruara, si dhe kostot dhe të hyrat e NPL-së.....	9
7.1 Qëllimi dhe objektivat	9
8. Organizimi dhe struktura e ndërmarrjes publike.....	10
8.1 Shërbimet e propozuara të grumbullimit të mbeturinave	10
9. Qasja për të mbajtur dhe të rritur shkallën e pjesmarrjes në treg	11
9.1 Marrëdhëniet me klient.....	11
9.2 Vetëdijesimi i popullatës.....	11
10. Kostoja financiare	12
10.1 Mirëmbajtja dhe amortizimi.....	12
10.2 Transporti	13
11. Tarifat për mbeturina dhe të hyrat	13
12. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2025.....	15
12.1 Të hyrat e planifikuara për vitin 2025.....	15
12.2 Shpenzimet e Planifikuara për vitin 2025.....	16
13. Strategjia promovuese.....	18
14. Rishikimi i rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave	18
15. Zbatimi	19
16. Organogrami i ndërmarrjes	20

1. Përbledhje e Përgjithshme

Plani i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes. Ky plan ofron informatat e nevojshme për menaxhmentin dhe Bordin e Drejtoreve lidhur me afarizmin e ndërmarrjes në periudhën 2025. Në këtë plan pëershkruhet afarizmi i bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes me qëllim të ofrimit të gjitha informatave të nevojshme të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve në ndërmarrje. Pjesa strategjike e këtij plani vazhdimesht monitorohet, rishqyrtohet dhe sipas nevojës mund të ndryshohet nga Bordi i Drejtoreve. Rëndësia e këtij plani strategjik është se i njëjti do të shërbej për Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes, si platformë për zhvillimin e ndërmarrjes dhe vendosjen e prioriteteve të investimeve në të ardhmen.

Detyrë thelbësore e NPL “PASTRIMI” SH.A është që të ofroj shërbime për grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në territorin e komunës. Duke u bazuar në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, ndërmarrjet e mbeturinave janë të limituara të kushtëzojnë klientët të paguajnë për shërbimet për grumbullimin e mbeturinave. NPL “PASTRIMI” SH.A është e vete-qëndrueshme dhe arrin mbulimin e plotë të kostos në vitin 2024. NPL “PASTRIMI” SH.A përkrahë finansiarisht në përputhje me nenin 59 dhe 60 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L- 066 në mënyre që të kemi një ambient të pastër për një jetë sa më të shëndetshme.

1.1. Aktivitetet primare dhe sekondare të ndërmarrjes

Veprimtaria kryesore e NPL “PASTRIMI” SH.A. është e përcaktuar në statutin e saj dhe përfshinë grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit dhe klientët tanë janë amvisëritë, bizneset dhe institucionet. Tani për tani aktivitete sekondare janë këto:

- Pastrimi dhe mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve;
- Mirëmbajtja e varrezave;
- Menaxhimi i stacionit transferues të mbeturinave;
- Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara;
- Mirëmbajtja e autoparqeve dhe parkingjeve
- Bartja e mbeturinave të ngurta
- Veprimtari të tjera shërbyese

2. Qëllimet, Vizioni dhe Misioni

2.1. Qëllimet e kompanisë

Qëllimi i NPL “PASTRIMI” SH.A, është angazhimi dhe mbulimi i tërë territorit të komunës me shërbime. Do të na nevojitet përkrahja e institucioneve komunale, pasi që kemi qëllimin e përbashkët për të ruajtur ambientin. Me një angazhim më të madh të Institucioneve komunale, do të ndalohej hedhja e mbeturinave rrëth fshatrave dhe lumenjve në komunën tonë.

2.2 Vizioni

Të jetë sinonim i pastrimit dhe të ndërtojmë imazh pozitiv për ambientin dhe hapësirën me ofrimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave për gjithë qytetaret e Hanit të Elezit.

2.3 Misioni

Shërbimi i lartë dhe çmime të përballueshme nga konsumatorët.

3. Swot Analiza

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> 1 Përmirësimi i shërbimeve për konsumatoret 2 Kompani publike pakonkurrent 3 Partner strategjik Komuna dhe Qeveria 4 Furnizim i mjaftueshëm me kontinjer 	<ul style="list-style-type: none"> 1 Defekte të shumta të mjetave lëvizëse 2 Vetëdijesim jo i lartë i qytetarëve 3 Papërgjegjësi e qytetarëve ndaj shërbimeve
Mundesitë	Kërcnimet
<ul style="list-style-type: none"> 1 Zgjerimi i shërbimeve dhe teritoreve të papërfshira 2 Furnizim me mjetë të reja të punës 3 Zgjerimi në ofrimin e llojeve të tjera të shërbimeve 	<ul style="list-style-type: none"> 1 Kostoja e lartë e investimeve në mjetë 2 Gjendja jo e mirë e mjetave të transportit Për shkak të vjetërsisë

4. Mjetet për matjen e performance-s

4.1. Indikatorët

SHKALLA E TË HYRAVE TË FATURUARA: / MBULIMI ME SHËRBIME PER KONSUMATORET E REGJISTRUAR : vlera e shërbimeve ndaj të hyrave të faturuara nga të gjithë kategoritë e klientëve, apo numri i konsumatorëve aktual në data bazë i ndarë për numrin e konsumatorëve të planifikuar për një vit.

SHKALLA E FATURIMIT/PERQINDJA E FATURIMT : numri i klientëve të faturuar ndaj numrit të klientëve të shërbyer, apo numri i faturave të lëshuara në raport me konsumatorët e regjistruar në data bazë.

SHKALLA E TË HYRAVE TË INKASUARA: të hyrat e inkasuara ndaj të hyrave të faturuara nga të gjitha kategoritë e klientëve.

SHKALLA E OPERIMIT 2/ NORMA E MBULIMIT TE PUNES : Të hyrat e inkasuara ndaj kostos së operimit duke përfshi edhe investimet.

BORGJET E KËQIJA- MUAJT E DEBITOREVE : Kontot e arkëtueshme të ndarë për shumën e faturuar për muaj.

INDEKSI I EFKASITETIT OPERUES/ EFKASITETI I STAFIT: Numri i punëtorëve për 1000 klient të faturuar, apo numri total i stafit i shprehur në 1000 pika faturuese.

5. Monitorimi

Ndërmarrja jonë ka përgatitur disa tregues financiar për të pasqyruar rrjedhën e të hyrave, faturimit, inkasimit etj. Të gjitha këto shabillonë do të përdoren në të ardhmen për të përcjellë progresin mujor, tremujor dhe vjetor dhe rrjedhën e zhvillimeve të përformimeve financiare të ndërmarrjes. Në fushën e monitorimit të punëtorëve, prioritet do të ketë forcimi i disiplinës së punës. Punëtorët do ti raportojnë për çdo dite eprorit të tij me të lartë duke e respektuar hierarkinë e strukturës organizative. Këto raporte mbi angazhimet ditore do të janë të përcjellë dhe do të janë kritere për vlerësimin e rezultateve të punës, dhe mos tregimi i rezultateve do të bien në pyetje se a do të ju vazhdohet kontrata apo jo. Çdo gjashtë muaj do të bëhet evoluimi i rezultateve të punës duke filluar nga stafi menaxhues e deri te stafi ndihmës.

6. Situata aktuale në menaxhimin e mbeturinave

6.1 Sasia dhe përbërja e mbeturinave

Sasia e mbeturinave kryesisht përbehet nga mbeturina të amvisërisë deri në 80% si dhe mbeturina komerciale 35%. Për fat ke keq ndërmarrja jonë nuk i ka kapacitetet e ndarjes dhe klasifikimit të tyre, por që shpresojmë ne një të ardhme të afërt edhe kjo të behet e mundur.

6.2. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe metodat e deponimit

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen për shumicën e gjeneruesve të mbeturinave në komunë. Në qendrën e qytetit, dy herë në javë kryhet shërbimi, ndërsa në zonat tjera të banimit, shërbimi kryhet një here në javë. Shërbimi, parmisht, kryhet gjatë katër ditëve të grumbullimit. Shërbimi kryhet edhe në rrugët e pjerrëta malore dhe në disa fshatra (Dimce, Pustenik, Gorancë, Krivenik dhe Rezhancë, Dremjak, Neçavc).

Gjeneruesit e mbeturinave përdorin kontejnerë të mbeturinave me rrota për mënjanimin e mbeturinave të tyre. Të gjitha amvisëritë janë pajisur me një kontejner me rrota të mbeturinave prej 120 litrave ndërsa bizneset dhe institucionet përdorin kontejner plastike prej 1,100 litrave.

Mbeturinat e mbledhura transportohen në stacionin e transferimit në Ferizaj- Gërlid (25 km nga Hani i Elezit) ose direkt në deponi në Gjilan - Velikinc, e cila është pak më shumë se 60 km larg. Edhe pse më larg, transportit në deponi është i preferuar sepse shkarkimi i lehte dhe i menjëhershëm i mbeturinave është i garantuar, ndërsa stacioni i transferimit shpesh është i stërmبushur.

Përveç grumbullimit të mbeturinave, kompania ofron shërbimin për pastrimin e rrugëve dhe parqeve si dhe aktivitete tjera qe ofrohen si kontraktues.

Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimimi menaxhohen nga vet gjeneruesit e mbeturinave. Me rimorkio të kamionit ose traktorit, gjeneruesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit transportojnë mbeturinave në një deponi përgjatë lumit Lepenc në pjesën veriore të komunës. Aty mbeturinat përdoren për të mbushur gropat e erozionit si përgatitje për realizimin e një parku përgjatë lumit. Mbikëqyrja e deponisë është shumë e kufizuar dhe herë pas here deponohen edhe mbeturina tjera përveç atyre të ndërtimit dhe rrënimit. Për më tepër, për shkak të mungesës së mbikëqyrjes, nuk verifikohet cilësia dhe pranueshmëria e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit.

Si përbledhje, mund të paraqitet tabela treguese në vijim me metodat e deponimit:

Lloji i mbeturinave	Sasia (t/vit)	Metoda e deponimit
Mbeturinat e amvisërisë	2550	Hidhen në deponi jashtë komunës
Mbeturinat e Komerciale	0	
Mbeturinat e ndërtimit	350 deri 650	Hidhen në deponi jashtë dhe brenda komunës
Mbeturinat industriale	0	

6.3. Aspekti organizativ dhe finançiar i menaxhimit aktual të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është përgjegjësi e NPL PASTRIMI SHA. U përmend edhe më lartë se për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave kemi arritur që përmes një donacioni të marrë nga Komuna te sigurojmë 600 kontejnerë për ekonomit familjare (gjeneruesit e mbeturinave) si dhe 100 kontinjer komposter.

Tarifat për shërbime të mbeturinave me faturim të ri:

- Amvisëritë që përdorin kontejner prej 120 litrave: 6,50 € në muaj
- Bizneset e vogla paguajnë nga 10,40 € në muaj
- Bizneset e mëdha që përdorin kontejnerët prej 1100 litrave paguajnë 16.90 € për zbrazjet e kontejnerit.
- Shërbime të veçanta (marrëveshje e veçantë)

Për deponimin e mbeturinave të grumbulluara qoftë në stacionin e transferimit ose në deponinë e përhershme, kompania për mbledhjen e mbeturinave paguan një tarifë prej 8.31 € për ton.

7. Organizimi, shërbimet e ofruara, si dhe kostot dhe të hyrat NP-së

7.1. Qëllimi dhe objektivat

Me themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale për Mbeturina, Komuna e Hanit të Elezit ka për qëllim të ju ofroj banorëve të komunës një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Për të realizuar këtë qellim të përgjithshëm, Komuna ka formuluar objektivat e mëposhtme që janë edhe në kuadër të Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Han të Elezit 2016-2024 disa prej te cilave janë arritur.

Masa 1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të përmirësoj shërbimet e grumbullimit të mbeturinave dhe synon të zgjerojë ofrimin e shërbimeve nga një mbulim prej 100% ashtu që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave t'i ofrohen gjithë gjeneruesve të mbeturinave në komunë.

Masa 2. Eliminimi i deponive ilegale

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur ti eliminoj 97% të deponive të paligjshme të mbeturinave deri në vitin 2024.

Masa3. Pastrimi/mirëmbajtja e tregut, hapësirave publike, varrezave dhe rrugëve

Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të lartpërmendura ka rëndësi të veçantë për komunën. Komuna ka për qëllim që të përmirësoj vazhdimisht pastërtinë e rrugëve dhe hapësirave tjera publike.

8. Organizimi dhe struktura e Ndërmarrjes Publike

Bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike dhe Ligjin për përmirësim të tij, Komuna e Hanit të Elezit ka formuar NPL “Pastrimi” Sh.a, me 100 % te aksioneve, e që struktura organizative e Ndërmarrjes Publike për Mbeturina të jetë sikur në Organogramin e mëposhtëm. Brenda këtij konteksti Komuna e Hanit të Elezit fillimisht ka zgjedhur Komisionin e Aksionarëve i cili përbëhet nga 3 anëtarë dhe i njëjtë komision (KKA) ka bërë zgjedhjen e 4 Drejtorëve dhe Kryeshefin Ekzekutiv si antarë i 5-të i Bordit. Bordi i Drejtorëve ka kryesuesin e vet.

Ndërmarrja parashihet të ketë dy Sektorë organizativ me njësitë e tyre punuese. Kryesuesi Ekzekutiv (drejtori menaxhues) do të menaxhojë të dy sektorët me punonjësit e propozuar më poshtë. Në Sektorin e Punëve Financiare do të jenë një ekonomist/kontabilist dhe 1 punëtor për shpërndarje të faturave dhe arkëtim. Sektori i Higjienës Komunale do të ketë 3 shofer, 10 grumbullues mbeturinash dhe 1 pastrues/mirëmbajtës të hapësirave publike si dhe 3 punëtor teknik për pastrim e objekteve shkollore dhe komunës.

8.1. Shërbimet e propozuara të grumbullimit të mbeturinave

Në mënyrë që të arrihet objktivi 1, të zgjerohet grumbullimi i mbeturinave nga niveli aktual i cili është 100% e grumbullimit të mbeturinave në 100% të gjithë gjeneruesve të mbeturinave, NPL PASTRIMI SHA ka për qëllim që të rris efikasitetin e pajisjeve të grumbullimit të mbeturinave.

Orari i grumbullimit të mbeturinave do të përcaktohet nga Departamenti i Shërbimit Publik në konsultim me Ndërmarrjen e Publike të mbeturinave. Paraprakisht, paraqitet orari i mëposhtëm.

Vendbanimi	Dita(t) e grumbullimit	Vendbanimi	Dita e grumbullimit
Hani i Elezit (Qyteti)	E Martë dhe e Premte	Neçavc	E hënë
Lagja e Re	E Hënë dhe e Mërkurë	Paldenicë	E Enjte
Dërmjak	E Hënë	Pustenik	E Hënë
Gorancë	E Mërkurë	Rezhancë	E Mërkurë
Krivenik	E Hëne	Seçishtë	E Hënë
Dimcë	E Martë	Laç	E Enjte

9.Qasja për të mbajtur dhe për të rritur shkallën e pjesëmarrjes në treg.

9.1. Marrëdhëniet me klient

Gjatë viteve 2019- 2024 kemi komunikuar dhe do të komunikojmë me klientët rreth :

Pranimi i kërkesave të drejtpërdrejta apo telefonike për intervenim në pastrim;

Kontakti me përfaqësues të lagjeve për bashkëpunim;

Identifikimi i klientëve të rinj;

Mesazhe për konsumator mes mjeteve të informimit apo ueb faqes së kompanisë; dhe

Kontakti me përfaqësues të fshatrave për bashkëpunim, lidhur me ofrimin e shërbimeve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.

9.2. Vetëdijesimi i popullatës

Një hap përpara për ndërmarrjen është organizimi i fushatave efektive të vetëdijesimit të popullatës, të përqendruara në:

- Ngritjen e vetëdijes së popullatës nëpërmjet shërbimit më të mirë të mbledhjes së mbeturinave;
- Inkurajimin dhe motivimin e klientëve për të paguar për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave;
- Dhënien e mesazheve të mirëfillta nëpërmjet kombinimit të duhur të mjeteve komunikuese.

Ne po ashtu përkrahim idenë për një kampanjë në nivel nacional, të organizuar nga të gjitha kompanitë e Kosovës përritjen e vetëdijesimit të qytetareve.

10. Kostoja financiare

Kostot operacionale të Ndërmarrjes së mbeturinave përbehen nga një numër i komponentëve të ndryshme. Secila prej komponentëve është përshkruar më poshtë dhe propozimet e përdorura janë paraqitur në llogaritje.

10.1. Mirëmbajtja dhe amortizimi

Një nga komponentët kryesore të kostove përfshin mirëmbajtjen dhe amortizimin e automjeteve. Tabela e mëposhtme paraqet asetet e domosdoshme dhe shpenzimet e përsëritura nga këto asete, si blerja dhe mirëmbajta e kamionëve teknologjik.

Gjatë viti 2024 kostoja e mirëmbajtjes së mjeteve dhe sigurimi i tyre kanë arritur vlerën rreth 17,000 euro.

	Lloji	copë	Çmimi blerjes	i	Totali
Kamion për grumbullim e mbeturinave - Isuzu(10-20 ton)	ASET	1	64.000		64.000
Kamion për grumbullim e mbeturinave - Man (8-12 ton)	ASET	1	31.500		31.500
Traktor -Tumosan	ASET	1	44.000		44.000
Vure - Për nevoja të Kompanisë	ASET	1	2500		2500
Kamion - Isuzu	ASET	1	69.000		69.000
Traktor DutzFahr	ASET	1	32.000		32.000

Një komponent tjetër është kostoja e fuqisë punëtore. Është menduar që të punësuarit do të bëjnë grumbullimin e mbeturinave dy herë në javë në Han të Elezit dhe lagjet urbane dhe një herë në javë në lokacionet tjera, duke i pastruar dhe mirëmbajtur shportat e mbeturinave dhe rrugët pranë. Ata pastaj do të transportojnë mbeturinat në stacionin e transferimit të mbeturinave në Ferizaj ose në deponinë e përhershme regionale në Gjilan. Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet e vlerësuara të punës së nevojshme për ofrimin e shërbimit.

Kosto e punës bruto	Njësi	Paga mujore	Paga vjetore
Pagesa e Drejtoreve të Bordit	4	470	5.640
Paga e Kryeshefit Ekzekutiv	1	737.68	8.852.16
Zyrtar i Kryesor Financiar - Thesarë	1	477.2	5.726.4
Arkatare	1	477.2	5.726.4
Sekretar	1	477.2	5.726.4
Zyrtar i prokurimit	1	145.35	1744.2
Kryepunëtor - Shofer	1	477.2	5.726.4
Shofera Kamjonit	2	864.22	10.370.64
Inkasant	1	424.52	5.094.24

Ngarkues mbeturinash	6	2.235.18	26.882.16
Punëtorë teknik	5	1.862.65	22.351.80
Totali	24	8.648.40	103.780.80

10.2. Transporti

Distanca e grumbullimit dhe frekuencia

Rruga	Mesatarja e distancës (km)	Distanca Mujore(km)
Rruga 1 (2 herë ne javë)		
Hani i Elezit	45	405
Rruga 2 (një here në javë)		
Perëndimi		
HE-Rezhancë-Gorancë	15	60
HE-Pustenik	10	40
HE-Seqishtë-Krivenik	13	52
Lindje		
Hani i Elezit-Dimcë	2	8
Hani i Elezit - Lac	12	50
Hani i Elezit-Paldenicë-Dërmjak	10	40
Neçavcë		
Deri te stacioni i transferimit në Ferizaj	50	400
Totali	157	1055

11. Tarifat për mbeturina dhe të hyrat

Kuvendi Komunal ka përcaktuar tarifat që do të paguhen për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Komuna do t'i bazojë tarifat në parimin e pagesës nga ndotësit sipas të cilët të gjithë gjeneruesit e mbeturinave do të duhet të paguajnë për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave që ata krijojnë. Megjithatë, për të pasur tarifa të volitshme, një formë e subvencionimit është dhe do të inkorporohet në sistemin e tarifës. Bizneset e mëdha, të cilët përdorin kontejner të mbeturinave prej 1100 litra, do të duhet të paguajnë një tarifë pak më të lartë për njësi (vëllim) të mbeturinave të krijuara, krahasuar me ato të amvisërisë.

Ata që jetojnë në varfëri do të lejohen të paguajnë një shkallë të tarifës së reduktuar, niveli i së cilës do të përcaktohet nga Kuvendi Komunal. Megjithatë, të ardhurat totale nga tarifat e grumbullimit të mbeturinave do të janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme të ofrimit të mbledhjes së mbeturinave dhe shërbimit të pastrimit të rrugëve.

Për të qenë në gjendje për të mbajtur tarifat në nivelin e tyre aktual, efikasiteti i mbledhjes së tarifës është përmirësuar që nga 2017 dhe planifikohet të arrijë nivelin e 100%. Me këtë rast duhet theksuar se tarifat mblidhen nga Ndërmarrja Publike.

Në mënyrë që të sigurohen të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, është aplikuar një metodë pro-aktive e mbledhjes së tarifës si dhe sanksionet për mos pagesë. Gjeneruesve të mbeturinave do t'ju kërkohet që të paguajnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në zyrat NP-së, por ata që nuk e bëjnë këtë do të vizitohen në vendin e tyre të banimit ose vendin e biznesit.

Për hedhjen e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi në lokacione për mbushje, një tarifë do të futet. Tarifa do të përcaktohet nga KK. Në tabelën e mëposhtme tregohen të hyrat e planikuara në Euro përmes mbledhjes së tarifave:

Llojet e Shërbimit	Çmimi/muaj	Çmimi për kontinier 120 litra	Çmimi për kontinier 1100 litra
Ekonomitë Familjare/Amvisëritë	6.50		
Bizneset e vogla	10.40		
Institucionet Publike		1x6.50 € për zbrasje	1x16.90 € për zbrasje
Ndërmarrjet e mëdha dhe ndërmarrjet me shërbime të veçanta (Sharrcem, Bankat, Terminali, Kosovaplast, Fabrika për përpunimin e mishit, Mishtoret etj) do të rregullohen me kontratë të veçantë	1200-1450 + TVSH	30 - 60 + TVSH	Me marrëveshje për shërbime të veçanta

12. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025

12.1 Të hyrat e planifikuara për vitin 2025

NPL PASTRIMI burimin e të hyrave e ka kryesish nga qytetarët (klient) te cilët janë të pajisur me kontrata që nënkupton se janë dakord me çmimet e shërbimeve të ofruara. Numri i kontratave për qytetarët apo ekonomi familjare është 1498, prej të cilave 1341 janë aktive dhe 157 janë jo të rregullta ku kryesish përfshihen bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë vendit dhe jashtë territorit të Hanit të Elezit. Gjatë vitit 2025 planifikojme qe të arrijmë deri ne 1570 kontrata aktive, bizneset nga 130 në 120L.

Institucionet publike gjithësej 10 gjithash tu përbejnë një rol kyç në të hyrat e kompanisë.

Nga institucionet publike kemi një marrëveshje me Komunën e Hanit të Elezit për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonën verore dhe dimërore që planifikojmë shumën deri në 65.000 euro për vitin 2025.

Çmimet për shërbime: Ekonomi Familjare 6.50 euro në muaj Bizneset e vogla 10.40 euro në muaj kurse bizneset e mëdha 16.90 euro për zbrasje, dhe institucionet publike 16.90 euro zbrasje mund ti planifikojmë në bazë të muajit të fundit të faturimit.

Si dhe korporatat nga 1200 deri ne 2500 + TVSH në muaj.

Tabela më poshtë paraqet të hyrat e planifikuara të kompanisë:

Ekonomi Familjare	Numri i Kontratave	Faturimi për 1 vit	
Aktive	1341	78	104.598
Të parregullta	157	13	2041
#	#	Totali	106.639
Përshkrimi	Numri i Kontratave	Faturimi për 1 vit	Gjithsej
Biznese të vogla	90	124.8	11.232
Biznese të mëdha	20	321.1	4.056
Institucione publike	12	20.079.6	20.079.6
Korporata	1	20.217.6	20.217.6
Marveshje me Komunën	1	65000	65000
#		Totali	120.585.2
Totali i Planifikimit		#	227.224.2

12.2 Shpenzimet e planifikuara për vitin 2025:

Shpenzimet e planifikuara të kompanisë kryesisht i përbëjnë këto kategori:

1. Paga dhe mëditje
2. Mallra dhe shërbime
3. Tatimet
4. Blerje për asete

Pagat dhe mëditjet

Pagat përfshijnë: pagat bazë, kontributi i punëdhënësit dhe pagesa për ushqim (2 euro duke llogaritur vetëm ditët e punës).

Mëditjet kryesisht përfshijnë bordin e drejtoreve të cilët planifikojnë të marrin 123.68 euro bruto apo 117.5 euro neto për mëditje si dhe ndonjë mëditje për trajnime.

Tabela më poshtë paraqet planifikimin e pagave dhe mëditjeve.

Përshkrimi	Nr	Paga Bazë	K. Punedh	Ushqimi	Për muaj	Për vit
Bordi i Drejtoreve	4	494.72	21.24	-	470	5,640.00
Kryeshefi Ekzekutiv	1	776.5	34.13	44	737.68	8,852.16
Zyrtar Financiar - Thesarë	1	524.21	21.19	44	477.2	5,726.40
Sekretar	1	524.21	21.19	44	477.2	5,726.40
Arkatare	1	524.21	21.19	44	477.2	5,726.40
Zyrtar i prokurorimit	1	170	5.35	-	145.35	1,744.20
Inkasant	1	462.84	18.13	44	424.52	5,094.24
Kryepunetor - Shofer	1	524.21	21.19	44	477.2	5,726.40
Shofer	2	925.68	36.26	88	864.22	10,370.64
Ngarkues	6	2,420.10	121.2	352	2,235.18	26,822.16
Punëtorë teknik	5	2,016.75	75.75	220	1,862.65	22,351.80
Totali	24.00	9,363.43	396.82	924.00	8,648.40	103,780.80
Mëditje për trajnime						1,000.00
Totali i Planifikuar						104,780.80

Mallra dhe shërbime

Mallrat dhe shërbimet do ti paraqesim përmes tabelës

Përshkrimi	Shuma
Špenzime për karburant	30.000
Shpenzimet e deponise (KMDK)	20.000
Shpenzimet e mirëmbajtjes se mjeteve	15.000
Shpenzimet e sigurimit dhe regjistrimit	6.000
Shpenzime për internet	150
Shpenzime për rrymë	800
Shpenzime për telefon	1.200
Shpenzime të reprezentacionit	340
Shpenzime për pajisje pune	5.000
Kompjuter dhe pajisje teknologjike	1.500
Inventar për zyrë	1.200
Shpenzime për trajnime	1.000
Licencë për program faturimi	400
Shpenzime për zyrë	1.000
Totali I Planifikuar	83.590

Tatimet

NPL PASTRIMI paguan tre lloje të tatimeve dhe planifikimi i shpenzimeve për tatime paraqitet përmes tabelës:

Përshkrimi	Shuma
Tatimi I Vlerës së Shtuar (TVSH)	7000
Këstet tremujore për Korporata TM	1200
Tatimi në Fitim CD	1000
Totali I Planifikuar	9200

Blerjet Kapitale

Nënkuptojnë blerje për asete të mjeteve si pjese shtese e mjeteve si: luge e për pastrimin e bores, kamionetë, hedhëse e krypes apo diçka që i nevoitet mjeteve.

Blerje Kapitale	Shuma
Asete për mjete	26427.8
Totali I Planifikuar	26427.8

13. Strategjia Promovuese


Aktiviteti Promovimit	Kostoja ne Euro	Afati kohorë dhe personi përgjegjës
Faqja zyrtare e Komunës	0	Pa afat të caktuar–Mehmet Ballazhi
Facebook - Faqjazyrtare NPL	0	Pa afat të caktuar–Hirman Kuka

14. Rishikimi i rregulloreve të menaxhimit të mbeturinave

Dispozitat që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave në Hanin e Elezit janë të përfshira në Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat janë miratuar nga Kuvendi Komunal (KK).

Rregullorja aktuale për mbrojtjen e mjedisit nuk përfshin detyrimin e gjeneruesve të mbeturinave për të paguar për shërbimin e mbledhjes dhe asgjësimit të mbeturinave. Për këtë arsyje NPL planifikon të rishikojë në mënyrë kritike rregulloren aktuale dhe do të propozojë te Kuvendi Komunal (KK) për përfshirjen e detyrimit e gjeneruesve të mbeturinave për të paguar tarifën e cila do të vendoset nga KK-ja dhe rishikuar në baza vjetore. Ajo do të propozon se mos-pagesa e taksës do të dënohet me gjobë.

**16. ORGANOGRAMI I PROPOZUAR I STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË NDËRMARRJES
PUBLIKE LOKALE PËR MBETURINA NPL "PASTRIMI" SH.A, HANI I ELEZIT**



15.Zbatimi

Pas miratimit të rishikimit, NPL do të fillojë zbatimin e dispozitave të menaxhimit të mbeturinave në rregulloren për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të Ligjit për mbeturina. Theksi i zbatimit do të vendoset në pagesën e tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Ata që i shmanget pagesës do të identifikohen duke krahasuar regjistrin e amvisërive dhe regjistrin e biznesit me faturën e lëshuar për pagesën e tarifës së menaxhimit të mbeturinave. Ata që nuk paguajnë do të vizitohen nga një inkasant i tarifave i cili në radhë të parë do të mbledhë vetëm tarifën dhe do të ofroj informata për shkaqet dhe nevojën e pagesës së tarifës për menaxhimin e mbeturinave. Në rast të shmangjes së zgjatur të pagesës dhe në rast të përsëritjes së shkeljes, inspektori përgjegjës për mjedisin do të shoqërojë inkasantin e tarifave dhe do të vendosë një gjobë mbi tarifën për grumbullimin e mbeturinave. Në një fazë të mëvonshme dhe një tarifë shtesë të mbledhjes së mbeturinave do të futet. Përveç kësaj aktivitetet e zbatimit do të synojnë parandalimin e largimit të paligjshëm të mbeturinave në komunë dhe rikuperimin e kostove të largimit të mbeturinave të paligjshme të deponuara nga kundërvajtësit. Nëse kërkohet, shkelësit do të merren në gjykatë. Megjithatë, aktivitetet e zbatimit do të kryhen vetëm në zonat e komunës, ku ofrohen shërbimet e mbledhjes së mbeturinave. Aktivitetet e zbatimit në fshatrat ku mbeturinat aktualisht nuk mblidhen do të nisin vetëm pas futjes së shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe kryerjen e një fushatë të ndërgjegjësimit publik. Përpara nisjes së mbledhjes së mbeturinave, gjeneruesit e mbeturinave do të inkurajohen që të transferojnë mbeturinat e tyre në një kontejner publik në qytetin e Hanit të Elezit

Hyrja në fuqi

Ky Plan hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2024

